



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:231964
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05429339

C-IV-14-0489

Ankuesi

M V, fshati G, Klinë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 06 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit, PEJ068-0137, të datës 26 dhjetor 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 25 janar 2014, ankuesi (nëpërmjet postës) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PEJ068-0137, datë 26 dhjetor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 7,981.85 € për periudhën janar 1991 – 01 qershor 1999 nga N. N. I. T. "Mirusha" Klinë (në likuidim). Ankuesi pohoi se grupi i parë i punëtorëve të dëbuar dhunshëm nga puna ishte nga janari i vitit 1991 ndërsa grupi i dytë ishte dëbuar nga janari i vitit 1997 dhe se i tërë procesi i tillë i dëbimit të punëtorëve ishte bërë në mënyrë të dhunshme mbi baza diskriminuese etnike duke u përjashtuar dhe përndjekur nga vendi i punës dhe ndërmarrja, edhe pse ndërmarrja kishte punuar dhe afaruar në mënyrë të rregullt deri në fillim të qershorit të vitit 1999 kur edhe ishte shkatërruar baza ekonomike dhe ishte bërë plaçkitja e të gjitha aseteve të ndërmarrjes. Është me relevancë për gjykatën se procesi i largimit të dhunshëm dhe diskriminues i viteve të 90-ta ishte apeluar me kohë në procedurë të rregullt si brenda në ndërmarrje, përmes kundërshtimit përkatës po ashtu

edhe jashtë ndërmarrjes pra deri te ish Gjykata e atëhershme Themelore e Punës së Bashkuar në Gjakovë, krejt kjo sipas legjislacionit pozitiv të kohës. Ky proces i apelimit ishte bërë në mënyrë të organizuar nga sindikati i ndërmarrjes dhe grupit profesional e cila kishte hartuar në mënyrë të rregullt dhe unike për të gjithë të dëbuarit, me specifikat përkatëse dhe i kishte deponuar ato në afat te organet interne të ndërmarrjes po edhe te gjykata kompetente. Pas krejt atij procesi të rregullt dhe të afatshëm ligjor të apelimit, i bërë nga të gjithë punëtorët dhe analogjisë së provave të tilla, për të gjitha rastet edhe kur ato mungojnë, nuk mund të konstatohet parashkrimi i çështjes, siç kishte menduar dhe vepruar AL duke u thirrur në Nenin 608 të ish LPB dhe duke refuzuar kërkesat pa të drejtë mbi atë bazë. Formulari i AL nuk kishte hapësirë të mjaftueshme për paraqitje të të gjitha provave dhe fakteve dhe sqarimit meritor të tyre si do që të jetë tani gjykata si organ gjyqësor respektabil meritor do të këtë në dispozicion të gjitha provat dhe faktet vendimtare për vendosje meritore, të cilat prova paraqesin kontinuitetin e afatshmërisë së kërkimit të mbrojtjes së çështjes lëndore nga punëtorët, kjo edhe ishte e natyrshme sepse asnjë nga punëtorët nuk ishte pajtuar me largimet dhe dëbimet diskriminuese etnike të atëhershme nga puna dhe ndërmarrja. Ankuesi më tej thekson se për rastet e tilla disa nga punëtorët varësisht nga stadi i procedurës gjyqësore kanë edhe vendimet dhe shkresat tjera të gjykatës përkatëse, në rastin konkret të ish Gjykatës Komunale në Klinë, te e cila gjykatë shihet se lëndët e tilla gjyqësore për vendosje të mëtejme i kishte ceduar ish Gjykata Themelore e Punës së Bashkuar në Gjakovë, siç ishte vepruar edhe në tërë Kosovën. Ankuesi më tej theksoi se të gjitha këto prova dhe fakte vendimtare tregojnë dhe orientojnë DHPGJS se lëndët e tilla ish Gjykata Themelore e Punës së Bashkuar në Gjakovë i kishte drejtuar te ish Gjykata Komunale në Klinë e cila normalisht ka pasur obligimin ligjor që të njëjtat të i ruaj dhe aktualizoj edhe pas luftës së fundit në Kosovë. Pas vitit 2000 si në tërë Kosovën po ashtu edhe punëtorët e N.N.I.T. “Mirusha” në Klinë kishin iniciuar dhe paraqitur ankesën tek Dhoma e Posaçme. Ankuesi më tej pohoi se si shkak i parë i paraqitjes së ankesës lëndore qëndron në atë se AL me rastin e vendosjes kontestuese kishte bërë shkeljet qenësore të dispozitave procedurale që rregullojnë çështjen konkrete dhe se është shkel parimi thelbësor ai i dëgjimit të palës tjetër si parim i çdo procedimi meritor ligjor dhe se në rastin konkret është dashur që AL të veproj drejtë ashtu siç e kishte të përcaktuar në vetë shkresën e ish AKM-së datë 7 shkurt 2006. Ankuesi më tej thekson se i është pamundësuar një e drejtë thelbësore procedurale që ka të bëjë me dëgjimin dhe sqarimin e palës procedurale. Kërkesa po dihet se është e afatshme ky është fakt vendimtar por nuk qëndron fare arsyeja tjetër ku thuhet se kërkesa është parashkruar duke iu referuar Nenit 608 të LPB apo nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës për paga për faktin se kjo kërkesë fillimisht ka lidhshmërinë e ankimit të rregullt të punëtorëve siç u cek më lart po ka lidhshmëri edhe me 20% që ka realizuar punëtori po edhe për faktin tjetër se kërkesa e tillë ka si rrjedhojë procesin e privatizimit dhe është e kushtëzuar nga ai proces dhe së fundi edhe vet obligimin e AL për kontaktimin e punëtorit. Ish AKM me datë 07 shkurt 2006 kishte lëshuar një njoftim përkatësisht qarkore për të gjithë punëtorët më sqarimin se pagat që u janë borxh punëtorëve do të mbesin përgjegjësi e ndërmarrjes dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe se punëtorët do të kontaktohen kur të fillojnë procedurat e tilla. Ankuesi më tej theksoi se në mbështetje ligjore të dispozitës neni 40 par.1 pika 1.6 dhe neni 1.6.1 të Ligjit nr.04/L-034 për AKP në të cilën palëve procedurale në rastet e kësaj natyre juridike iu garantohen 3 paga bruto dhe se kërkesat e tilla kanë tretmanin e kërkesave prioritare të garantuara. Ankuesi më tej thekson se sipas Rregullores së UNMIK-ut

nr.1999/24 datë 12 dhjetor 1999 parasheh si ligj të zbatueshëm në Kosovë ligjin në fuqi të datë 22 mars 1989 sipas së cilës rregullore vlejnë edhe konventat tjera ndërkombëtare edhe sot sipas Kushtetutës së Kosovës kanë përparësi zbatimi në Kosovë.

Ankuesi i propozon gjykatës që ankesa e tij të miratohet në tërësi si e bazuar, ashtu që pas rishikimit të vendimit të AL i njëjti të ndryshohet në kuptim të njohjes të së drejtës së ankuesit në kompensimin e 101 (njëqindnjë) pagave mujore të papaguara nga janari i vitit 1991 e deri në qershor të vitit 1999, në lartësi prej gjithsej 7,9815 € dhe atë me kamatë ligjore nga data e parashtrimit të padisë më 28 dhjetor 2007 sipas evidencës gjyqësore SCC-07-0554, e deri në pagesën definitive, krejt këtë në afatin parativ 15 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nga ana e AKP-së, e nën kërcënim të përmarimit me dhunë duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore lartësia e të cilave caktohet me vendim të veçantë të gjykatës. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur në kopje dëshmitë si: Vendimin mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës së ankuesit nr. 159 datë 12 janar 1991, lëshuar nga NSH “Mirusha” Klinë, Kundërshtimin e ankuesit ndaj vendimit mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës drejtuar e Organit të Përkohshëm të NSH “Mirusha” Klinë datë 24 janar 1991, Propozimin e ankuesit për prishjen – anulimin e vendimit për shkëputjen e marrëdhënies së punës drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar në Gjakovë datë 26 shkurt 1991, Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar nga AKM (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit) datë 07 shkurt 2006 (shabllon) dhe Vendimin e kundërshtuar.

Me 21 prill 2016, e paditura AKP-ja parashtrori mbrojtjen e saj në të cilën pohoi se i përmbahet qëndrimit se në marrjen e vendimit mbi kërkesën e ankuesit AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontekst, Neni 70.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033 parashikon që ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 70 par. 2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, në pajtim me qëndrimet e vetë ankuesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për ta shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 70.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 ankesa në fjalë është e pabazuar. Gjithashtu, ankuesi ka dështuar të ofroj ndonjë argument ligjor në mbështetje të ankesës së tij dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parashikon që një “*ankesë duhet të përmbajë ...argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet ankesa*”. Në vend të argumenteve ligjore, ankuesi ka deklaruar se nuk bie dakord me vendimin e AL dhe se ligji i zbatuar nga AL nuk mund të zbatohet në lidhje me çështjen. E paditura thekson se periudha e parashkrimit filloi të rrjedhë nga 1991 pra nga momenti që kanë lindur pretendimet e ankuesit. Qëndrimi i të paditurës është se periudha e parashkrimit nuk e lejon AL dhe / ose Dhomën e Posaçme të analizoj dhe shqyrtojë themelin e çështjes. Me fjalë të tjera, AL dhe Dhoma e Posaçme nuk mund të nxjerrin

vendim në lidhje me ndonjë borxh të mundshëm të NSH-së për paga të papaguara ose kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës ndaj ankuesit. Vendimi i vetëm që merret në këtë proces, është se kërkesa është e parashkruar. Afati i parashkrimit ia ndalon çdo autoriteti të marrë vendim mbi themelin e rastit. Fakti se ankuesi ka dorëzuar një padi në Gjykatën Themelore në Gjakovë datë 26 shkurt 1991, nuk dëshmon ndërprerjen e parashkrimit sepse në radhë të parë kjo padi nuk lidhet me objektin e kësaj çështjeje. Ankuesi ka pretenduar përmes kësaj padie anulimin e vendimit mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës dhe jo paga të papaguara. Për më tepër padia nuk konsiderohet ndërprerje e parashkrimit duke qenë se kërkesa e kreditorit nuk konsiderohet ndërprerje e parashkrimit në përputhje me dispozitat e LMD. Dhoma e Posaçme ka konfirmuar vazhdimisht këtë arsyetim ligjor përmes juridiksionit të saj (*shih, ex multis*, Aktgjykimin C-IV-13-0889, datë 25 mars 2014 – sipas gjykatës, vendimi i kundërshtuar i AL i lidhur me një situatë të tillë është i saktë dhe i mirë bazuar, ashtu si edhe aktgjykimi SCL-11-0046 dhe C-II-13-0190 datë 14 janar 2014). Po ashtu e paditura thekson se aktgjykimet me nr. C-II-13-0190 datë 14 janar 2014 dhe C-IV-13-0969 të cilat po ashtu njohin zbatimin e Nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe Nenin 608 të LPB, kanë formë të prerë. Ankuesi ka pretenduar se e ka dorëzuar kërkesën në likuidim gjatë kohës që AKP-ja e ka udhëzuar ta bëjë këtë. E paditura mban qëndrimin se AKP asnjëherë nuk ka këshilluar dikë të kufizohet nga dorëzimi i padive në gjykatat e Kosovës. E drejta për të paraqitur një kërkesë në gjykata është e drejtë e garantuar kushtetuese e cila nuk mund të kufizohet. Njoftimi të cilit i referohet ankuesi, i datës 07 shkurt 2006, qartësisht e ka njoftuar atë mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe se detyrimet e mundshme do të shqyrtohen gjatë procedurës së likuidimit dhe në fakt kështu ka ndodhur, kërkesa e tij u shqyrtua dhe u gjet e parashkruar. Vlen të theksohet se letra në fjalë është një shabllon që i është dërguar mijëra punëtorëve pa kurrfarë konsiderate për borxhet konkrete që NSH-ja mund ti kishte atyre – por bazuar në faktin e vetëm që emrat dhe adresat e këtyre punëtorëve kanë figuruar në arkivin e NSH-së. E paditura më tej theksoi se kërkesa e ankuesit është edhe e pabazuar duke qenë se ai nuk ka qenë efektivisht në punë nga viti 1991 e deri më 1999, pra nuk ka ofruar asnjë shërbim pune në NSH-në dhe si rrjedhojë nuk mund të pretendojë të shpërblehet për një periudhë gjatë së cilës ai nuk ka ofruar asnjë shërbim pune. Në lidhje me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar, e paditura vlerëson se ky pretendim nuk lidhet me objektin e kësaj çështjeje. E paditura thekson se kërkesat për diskriminimin të cilat mund të jenë të vlefshme në bazë të Nenit 10/4 të Rregullores 2003/13 mund të regjistroheshin në Dhomën e Posaçme vetëm në rastet kur ka kontestime në lidhje me listën e shpërndarjes së 20% të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes dhe nuk lidhen me rastin kur ankuesi pretendon paga të papaguara para AL. Neni 608 i LPB është në pajtim të plotë me Ligjin mbi Ndërmarrjet prandaj nuk është shfuqizuar dhe ka vazhduar të jetë në fuqi. Rrjedhimisht, argumenti i ankuesit është i pabazuar. E paditura më tej thekson se Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 është shfuqizuar nga Ligji Nr.03/L-212 (Neni 99.1) dhe prandaj nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për të pranuar ankesën e ankuesit. Përveç kësaj, Rregullorja në fjalë është përjashtuar qartësisht nga zbatimi në procedurat e likuidimit nga Neni 6.3 i Ligjit Nr.03/L-067 për AKP-në i cili parashikon se: “rregullorja 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës nuk do të zbatohet në lidhje me ndonjë veprim të ndërmarrë nga AKP.

E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe / ose të pabazuar si dhe të vërtetoj (lërë në fuqi) vendimin e AL në pajtim me Nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit

Nr.04/L-033. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur Vendimin për Fillimin e Likuidimit dhe Emërimin e Anëtarëve të AL, datë 16 shtator 2013.

Me 17 maj 2016, mbrojtja e të paditurës iu dorëzua ankuesit, e cila u pranua nga i njëjti me 24 maj 2016 dhe asnjë përgjigje nuk u dorëzua.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në shkresat e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës, megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për kompensimin e kërkuar në këtë lëndë (për 101 paga të papaguara në shumë prej 7,981.85 € për periudhën janar 1991 – 01 qershor 1999 nga NSH “Mirusha”) ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të papaguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës dhe pohimeve të vet ankuesit, i njëjti kërkesën për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën janar 1991 – 01 qershor 1999, e ka parashtruar në Autoritetin e Likuidimit më 01 nëntor 2013, që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Kërkesa e ankuesit për pagat e pa paguara për periudhën janar 1991 – 01 qershor 1999, është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar, që i bie se afati i parashkrimit për pagën e fundit ka arritur në qershor 2002, ankuesi kërkesën e ka parashtruar në muajin nëntor 2013, që do të thotë jashtë çdo afati të paraparë ligjor. Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore

apo se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para qershorit 2002, kështu do të kishim edhe ndërprerje të afatit të parashkrimit.

Gjykata është tërësisht në dijeni për rastet e tilla dhe ka marr parasysh pretendimet e ankuesit për largimin e tij nga puna në bazë të diskriminimit (si të gjithë punëtorëve të tjerë shqiptarë, të larguar në atë kohë nga aplikimi i masave të dhunshme), por nuk ka mundur të ofroj një zgjidhje tjetër ligjore, sa i përket kompensimit të kërkuar për paga të papaguara për periudhën kohore 1991 – 1999, kjo pasi ka kaluar një kohë jashtëzakonisht e gjatë nga ai moment deri në momentin e paraqitjes së kërkesës së tij në procedurë të likuidimit.

Gjykata ka marr parasysh gjithashtu faktin e inicimit të kundërshtimeve nga punëtorët e NSH-së në gjykatën e atëhershme (sipas dëshmimeve të dorëzuara në këtë rast, përfshirë: Propozimin për anulimin e vendimit të shkëputjes së marrëdhënies së punës të ushtruar nga ankuesi drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar në Gjakovë nr. 565/21 datë 26 janar 1991) dhe parashtrimin të padisë SCC-07-0554 të parashtruar me 28 dhjetor 2007, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme që është dorëzuar nga punëtorët e NSH-së, por të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe, siç edhe u arsyetua më lartë. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit në lidhje me raste të tilla dhe këtë NSH (AC-I-21-0462, AC-I-22-0651, etj.).

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 30.00 € për ankesën e parashtruar dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar